BASHKIA / QARKU
[PRRENJAS /ELBASAN]

Relacioni i përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm vendor, 2025-2027

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
2025 - 2027

1. HYRJE 5

1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR 5
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË 7

2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË 9

2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE 9
2.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË PRRENJAS 10

3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË / KËSHILLIT TË QARKUT 12

3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË 12
3.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJA E PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRFITUESIT 13

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË PRRENJAS 2025-2027 14

4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË PRRENJAS NË VITET 2025-2027 14
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Prrenjas për vitet 2025-2027 15
2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Prrenjas për periudhën 2025-2027 27
4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR 37

5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE 40

5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit 56
5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit 83
5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit 96
5.1.4 Informacion Bazë mbi Programin 98

Lista e Tabelave

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë Prrenjas 14
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit 15
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike. 28
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike 29
Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funksional 33
Tabela 6 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit 57
Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit 83
Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit 96
Tabela 9. Informacione bazë mbi Programin 98

Lista e Shkurtimeve

PBA – Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV – Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP – Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS – Grupi për Menaxhimin Strategjik
MF – Ministria e Financave
FPT – Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT – Instituti i Statistikave
PBB – Produkti i Brendshëm Bruto
SMBV – Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor

Projekt Programi Buxhetor Afatmesëm 2025-2027

Në bazë të:

- Neneve 4, 24 dhe 47 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
- Nenit 35, të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
- Nenit 8, pika 8(b), dhe Nenit 27 të ligjit Nr. 10296/2010, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",
- Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".
- Udhëzimit Nr.3 datë 28.02.2024, të Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027".
- Në zbatim të Urdhërit Nr.104 Datë 08.02.2024 është ngritur grupi i punës për hartimin e PBA për vitet 2025-2027.

Mbështetur në Vendimin e Këshillit Bashkisë Prrenjas Nr. 51 datë 27.03.2024 "Për miratimin e Tavaneve pergatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Prrenjas'', konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresë Nr.421/1 datë 02.04.2024.

"Për miratimin e Tavaneve pergatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Prrenjas" konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresë Nr.421/1 datë 02.04.2024. Pas miratimit të Tavaneve Buxhetore dhe në bazë të Urdhërit të Brendshëm Nr.104 Datë 08.02.2024 ngritur grupi i punës për hartimin e PBA për vitet 2025-2027. Ekipet e menaxhimit të ngritura për çdo program kanë bërë grumbullimin dhe analizimin e të dhënave duke u konsultuar dhe me grupet e interesit dhe qytetarët, si dhe me komisionin këshillimor dhe qytetar në Bashkinë Prrenjas. Gjithashtu do realizohet publikimi i PBA-së në këndin e njoftimeve zyrtare të bashkisë Prrenjas dhe në tre njësitë administrative Rrajcë, Qukës, Stravaj, duke diskutuar me Grupin e Menaxhimit Strategjik treguesit e buxhetit Afat-Mesëm 2025-2027 .

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës* së *Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e perfomancës të lidhura me ato në terma SMART[1]. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë[2] (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjecare[3], sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

[1] **S**pecifike, **M**atshme, **A**rritshme, **R**ëndësishme, **T**erma **K**ohore.
[2] 'Afatgjatë' I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.
[3] Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së . Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart[4] i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt

[4] Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Proçedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2025-2027 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavaneve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së

2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë Prrenjas

2.1 Situata e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore

(Burimi i Informacionit: Plani i Përgjithshëm Vendor / Plani i Zhvillimit Strategjik PPV/PZHS)
Bashkia Prrenjas shtrihet brenda territorit të qarkut Elbasan. Rajoni gjendet në pjesën jug-lindore të trungut të brendshëm të vendit dhe ka si kryeqëndër qytetin e Prrenjasit. Në nivel qarku bashkia shtrihet në pjesën jug-lindore dhe kufizohet në veri me bashkinë Librazhd të qarkut Elbasan, ndërsa në lindje me shtetin fqinjë, Maqedoni. Në jug kufizohet me bashkinë Pogradec të Qarkut Korcë dhe në perëndim me bashkinë Gramsh dhe bashkinë Elbasan.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Qytetet dhe fshatrat nën juridiksion të bashkisë	Populsia sipas Census 2011	Populsia sipas Regjistr	Sipërfaqja KM²
Elbasan	Qyteti Prrenjas	Qyteti Prrenjas, Fshatrat; Prrenjas-Fshat, Fshatrat; Qukës Shkumbin, Qukës Skënderbej, Skroskë, Mënik, Gurrë, Bërzeshtë, Fanjë, Karkavec, Dritaj, Pishkash, Fshatrat; Rrajcë, Sutaj, Skënderbej, Bardhaj, Katjel, Kotodesh, Urakë Fshatrat; Stravaj, Stranik, Farret, Shqiponjë,	24,906	33,474	322.95



Popullsia**:* Bashkia Prrenjas ka ***33 471 banorë dhe një sipërfaqe prej 323 km^2.
Bashkia Prrenjas përbëhet nga 4 njësi administrative: Prrenjas, Qukës, Rrajcë dhe Stravaj.
Bashkia ka nën administrimin e saj 1 (një) qytet dhe 26 (njëzetë e gjashtë) fshatra.
Qyteti ka një ekonomi disi te ekuilibruar, kryesisht të ardhurat sigurohen nga emigrimi në zonat e rajonit përreth dhe nga biznesi i vogël. Pjesë e bashkisë janë edhe disa fshatra turistikë. Zonat rurale merren kryesisht me bujqësi dhe blegtori.

Teritori i Bashkisë shtrihet në zonën malore, mjedisi natyror është i pastër dhe me shumëllojshmëri peisazhesh dhe burime të pasura natyrore dhe ujore. Elementet natyror të njohur janë malet e Sopotit, Rrajcës dhe Shebenikut. Përsa i përket infrastrukturës së transportit, Bashkia mban lidhje rrugore me njësitë administrative, duke mirëmbajtur ato me

mundësitë e pakta që ka. Gjithashtu bashkia mirëmban dhe rrugët që lidhen me fshatrat e të gjithë njësive administrative megjithëse në vendbanimet më të largëta është veçanarisht problematike duke pasur parasysh sipërfaqen e madhe të bashkisë dhe distancën e madhe në kilometra të rrjetit që lidhin qytetin me fshatrat më të largëta.Numri i popullsisë i regjistruar sipas censusit të fundit në këtë bashki ka dalë 35,000 banorë. Ndërsa numri popullsisë i regjistruar në gjendjen civile është 33.414 banorë.

Sipas ndarjes administrative Qyteti Prrenjas ka 8,928 banorë ose 26.7%, njësia administrative Qukës ka 10,739 banorë ose 32.1%, Njësia administrative Rrajcë ka 10.890 banorë ose 32.6% dhe njësia administrative Stravaj ka 2.853 banorë ose 8.6 % të popullsisë gjithsej.

Sipërfaqja totale e bashkisë Prrenjas është 323 km^2 ose 0.96 km^2 për banorë, sipërfaqe sipas njësive:Njësia administrative Rrajcë 61.2 km^2, Njësia administrative Qukës është 126.6 km^2 , njësia administrative Stravaj 121. km^2 dhe Qyteti Prrenjas bashkë me fshatrat, Prrenjas fshat dhe Rashtan 14.2 km^2.

Në planifikimin buxhetor, Bashkia ka prioritet çdo vit përmirësimin e infrastrukturës si në qytet ashtu edhe në fshatrat përreth.

Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore me shtrirjen e rrjetit të kanalizimeve dhe shumë projekte në vijim janë përqëndruar në shtrirjen e këtij standarti edhe në fshatrat që tashmë janë pjesë e administrimit të bashkisë.

Veç ndërhyrjeve në infrastrukturë, bashkia ka orientuar buxhetin e saj në shërbime ndaj komunitetit, institucione të dedikuara, çerdhe, kopshte, shkolla, qendra shëndetësore, qendra për moshën e tretë, mbështetje për njerëzit në nevojë, duke i qëndruar kështu më pranë nevojave të banorëve.

Zhvillimi i turizmit në këto vite ka qenë dhe vijon të jetë një drejtim i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik për Prrenjasin.

2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë Prrenjas

(Burimi i Informationit: PPV / PZHS

1-Çështje kryesore dhe me problematikë është infrastruktura rrugore. Projektet dhe politikat afatmesme dhe afatgjata të Bashkisë konsistojnë në ndërhyrjen për përmirësimin e akseve rrugore që lidhin qendrën e Bashkisë me qendrën e njësisë administrative Stravaj dhe më pas me përmirësimin e rrjetit rrugor midis njësive administrative dhe midis fshatrave. Është vërtet një sfidë pasi është një njësi administrative me një largësi 20 km dhe janë 26 fshatra të tjerë të njësive administrative që lidhen me qendrën e bashkisë me një largësi të konsiderueshme .

2-KUZ- Një problem serioz ka qënë edhe është Kanalet e ujërave të zeza në qytetin e Prrenjasit një rrjet tejet i amortizuar,me problematike dhe defekte të shumta kërkon ndërhyrje të menjëhershme është ndër prioritetet kryesore të politikave të investimeve të bashkisë pasi lidhet drejtpërdrejt me shendetin e banorëve të qytetit.Në territorin e bashkisë është e domosdoshme ndërhyrja për rehabilitime dhe zgjatje të kanaleve ujitëse. Kjo do të nxiste fermerët të rritnin sipërfaqen e kultivuar të tokës pasi dhe ujitja do të ndikonte në rritjen e rendimentit të prodhimin kjo me interes për fermerët e zonës sonë.

3-Mbrojtja e mjedisit është prioritet në politikën e investimeve afatmesme prandaj dhe synimi është përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve, paisja me kosha të rinj dhe mbledhja dhe dërgimi i mbetjeve në venddepozitimin në landfillin rajonal.

4- Njësia administrative Qukës Bashkia Prrenjas ndodhet buzë lumit Shkumbin, ku ky lum herë pas here nga gjatësia që ka nga malet e Sopotit dhe nga malet e Mokrës së sipërme të cilët në periudhën e rreshjeve përbëjnë një rrezik potencial për dalje nga shtrati dhe përmbytje të tokës bujqësore që shtrihet gjatë lumit këtu duhet ndërhyrje për vendosje pritash, urash.

5-Pyllëzimi i kurorës qytetit dhe mbjellja e pemëve në zona të caktuara të qytetit është prioritete politikave të investimeve dhe në vazhdimësi.

6-Shërbimi shëndetësor sidomos në zonat rurale duhet përmirësuar kjo për shkak edhe të mungesës ambjenteve si ambulanca në fshatrat e njësive administrative.


7- Veç ndërhyrjeve në infrastrukturë, bashkia ka orientuar buxhetin e saj në shërbime ndaj komunitetit,

Krijimi i kushteve të përshtatshme në shkollat ekzistuese si dhe ndërtimi objekteve të reja shkollare në qytet dhe në ato fshatra ku numri nxënësve e justifikon këtë shërbim pasi kemi shkolla të dëmtuara dhe nxënësit rrinë në ambiente me qera ku nuk krijohen kushtet e duhura të zhvilluar procesin mësimor. Si dhe krijimin e qendrave ditore, qëndra për moshën e tretë, kjo një risi për bashkinë Prrenjas. Me administrimin efektiv të buxhetit të saj si edhe me mbështetjen e qeverisë dhe donatorëve, Bashkia Prrenjas përgjatë këtyre vite buxhetore do të zbatojë programe e projekte të rëndësishme zhvillimi pjesë e vizionit të saj strategjik për zhvillimin e Prrenjasit dhe përmirësimin e jetesës së banorëve në qytet dhe fshat

3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë / Këshillit të Qarkut

3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

(Burimi i Informacionit: PPV / PZHS)



3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsyet dhe Përfituesit

(Burimi i Informacinit: PPV / PZHS; Fishat e Projekteve, të tjera)

Projekte Strategjike të bashkisë Prrenjas

01.U - RIAFTËSIMI I ZONËS SË PRRENJASIT, I ZONËS SË ISH MINIERËS DHE I KRIJIMIT TË NJË PIKE REFERIMI PËR KOMUNËN
02.U - RIAFTËSIMI I IDENTITETIT DHE FUNKSIONIMI I QENDRAVE DHE I FSHATRAVE
03.U - RIORGANIZIMI I UDHËZIMEVE NË LIDHJE ME MAQEDONINË
04.U - REALIZIMI I NJË QENDRE PRODHIMI I UJËRAVE MINERALE NË RRAJCE
05.U - RIAKTIVIZIMI I SISTEMIT PRODUKTIV I MINIERAVE
06.N - REALIZIMI I SISTEMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE: MBLEDHJA, DEPOZITIMI DHE DIEGIA/SHKARKIMI
07.N - PROJEKTI I SISTEMIT TURISTIK I ORIENTUAR NË VLERAT E SISTEMIT TË PEISAZHIT NATYROR
08.A - ZGJERIMI DHE RIORGANIZIMI I SISTEMIT TË PRODHIMTARISË AGROUSHQIMORE
09.Ë - RESTAURIMI I RRJETIT HIDROGRAFIK
10.I - RIAKTIVIZIMI I RRJETIT HEKURUDHOR
11.I RIAFTËSIMI I AKSEVE TË NDRYSHME(AUTOSTRADA) DHE QËNDRUESHMËRI NDËRMJET QENDRAVE KRYESORE

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË PRRENJAS 2025-2027

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Prrenjas gjatë periudhës 2025-2027, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2025-2027, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2025-2027. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia Prrenjas.

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

Tabela 1. Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë Prrenjas

Raporti **PBA9 - Informacion mbi**

NJVQV 153 - Bashkia Përrenjas

: 2025 - 2027

		Të Përgjithshme	2020	2021	2022	2023	2024
1	**Numri i Njësive Administrative**	4.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2	**Numri i Fshatrave**	25.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3	**Sipërfaqja e NJVQV (km2)**	322.99	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3.1	Qyteti	12.90	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3.2	Njësitë Administrative	310.09	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4	**Sipërfaqja e NJVQV (km2)**	223.86	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.1	Zonë Urbane	8.59	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.2	Tokë Bujqësore	38.92	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.3	Kullota	18.41	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.4	Pyje	157.94	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
5	**Popullsia e NJVQV**	0.00	33,251.00	33,232.00	33,222.00	33,232.00	33,286.00
5.1	Qyteti	0.00	8,926.00	8,895.00	8,854.00	8,830.00	8,831.00
5.2	Njësitë Administrative	0.00	24,325.00	24,337.00	24,368.00	24,402.00	24,455.00
6	**Mosha Mesatare e Popullsisë**	0.00	62.00	61.00	60.00	62.00	60.00
7	**Numri i Lindjeve**	0.00	106.00	73.00	56.00	44.00	23.00
8	**Numri i Vdekjeve**	0.00	206.00	188.00	87.00	34.00	23.00
9	**Numri i Bizneseve Aktive**	0.00	454.00	438.00	398.00	410.00	478.00
10	**Numri i Familjeve**	0.00	10,677.00	10,756.00	10,857.00	10,934.00	11,039.00
10.1	Qyteti	0.00	2,872.00	2,867.00	2,892.00	2,920.00	2,926.00
10.2	Njësitë Administrative	0.00	7,805.00	7,889.00	7,965.00	8,014.00	8,113.00
11	**Numri i Punonjësve të NJVQV me Kohë të Plotë**	0.00	305.00	331.00	330.00	323.00	322.00
		TëPërgjithshme	2020	2021	2022	2023	2024
11.1	Administrata e NJVQV	0.00	304.00	330.00	329.00	322.00	321.00
11.2	Njësitë Shpenzuese	0.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
12	**Numri i Punonjësve të NJVQV me Kohë të Pjesëshme**	0.00	3.00	3.00	4.00	4.00	5.00
12.1	Administrata e NJVQV	0.00	2.00	2.00	3.00	3.00	4.00
12.2	Njësitë Shpenzuese	0.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
13	**Numri i Programeve Buxhetore**	0.00	12.00	12.00	12.00	14.00	14.00

4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Prrenjas në vitet 2025-2027

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Prrenjas për vitet 2025-2027

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Në bazë të Udhëzimit nr 3 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027" Burimet e financimit për PBA 2025-2027 janë paraqitur si më poshtë:

Burimet e financimit për vitin 2025-2027

Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit

Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave

NJVQV: 153 - Bashkia Përrenjas

PBA: 2025 - 2027

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	Burimet Buxhetore	2022 Fakti	2023 Fakti	2024 Plani Fillestar	2024 Plani i Rishikuar	2025 Plani	2026 Plani	2027 Plani
1	**TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA**	74,535	67,173	115,500	115,500	118,297	126,000	126,380
1.1	**TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME**	9,963	11,283	12,976	12,976	13,850	14,130	14,900
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	5,927	6,702	7,379	7,379	7,500	7,590	8,000
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	2,812	3,183	3,886	3,886	4,600	4,690	4,830
1.1.3	Taksa mbi truallin	1,224	1,398	1,711	1,711	1,750	1,850	2,070
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	0	0	0	0	0	0	0
1.2	**TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA**	11,216	6,832	18,000	18,000	17,500	18,000	18,000
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	11,216	6,832	18,000	18,000	17,500	18,000	18,000
1.3	**TAKSA TË TJERA VENDORE**	2,497	2,867	3,087	3,087	2,350	2,360	2,380
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	241	202	0	0	500	500	500
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	0	7	20	20	100	100	100
1.3.3	Taksa e tabelës	1,559	1,670	1,749	1,749	1,750	1,760	1,780
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0	0	0	0	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	697	988	1,318	1,318	0	0	0
1.4	**TARIFA VENDORE**	45,161	29,960	52,437	52,437	49,470	58,350	58,410
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	7,688	10,140	15,299	15,299	25,000	26,000	26,000
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	0	0	0	0	0	0	0
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	1,979	1,972	2,359	2,359	3,000	3,470	3,470
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	733	734	1,458	1,458	2,000	2,500	2,500
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	12,216	1,979	6,125	6,125	5,740	9,680	9,700

	Burimet Buxhetore	2022 Fakti	2023 Fakti	2024 PlaniFillestar	2024 Plani i Rishikuar	2025 Plani	2026 Plani	2027 Plani
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	2,776	3,549	3,700	3,700	5,500	6,200	6,700
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	0	0	0	0	0	0	0
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	15,695	4,386	14,000	14,000	0	0	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	192	211	228	228	230	235	240
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	2,550	3,925	3,500	3,500	2,150	2,600	2,600
1.4.11	Tarifa e parkimit	0	0	0	0	0	0	0
1.4.12	Tarifa të tjera	1,332	3,064	5,768	5,768	5,850	7,665	7,200
1.5	**TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK**	5,467	14,882	13,000	13,000	11,000	11,000	11,000
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarjet publike	0	0	0	0	0	0	0
1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë	5,467	13,692	13,000	13,000	11,000	11,000	11,000
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	1,190	0	0	0	0	0
1.5.5	Shitja e aseteve financiare	0	0	0	0	0	0	0
1.5.6	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0	0
1.5.7	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
1.6	**TË TJERA ADMINISTRATIVE**	231	1,349	16,000	16,000	24,127	22,160	21,690
1.6.1	Kamatëvonesat	0	0	0	0	0	0	0
1.6.2	Gjoba, sekuestrime dhe zhvdëmtime	231	1,324	2,000	2,000	300	850	850
1.6.3	Të tjera	0	25	14,000	14,000	23,827	21,310	20,840
2	**TRANSFERTA NGA BUXHETI QËNDROR**	307,891	343,314	397,740	397,740	427,070	443,451	461,884
2.1	**TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME**	179,902	207,978	232,055	232,055	245,609	260,588	276,687
2.1.1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	179,902	207,978	232,055	232,055	245,609	260,588	276,687
2.2	**TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE**	110,148	114,149	145,485	145,485	157,761	159,063	160,377
2.2.1	Konviktet e arsimit parauniversitar	0	0	0	0	0	0	0
2.2.2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor	49,572	51,677	49,793	49,793	49,793	50,291	50,793
2.2.3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	0	0	5,970	5,970	5,970	6,030	6,090
2.2.4	Arsimi parauniversitar	3,780	3,908	4,348	4,348	4,348	4,391	4,435
2.2.5	Mbrojtja nga zjarri	16,341	17,080	18,208	18,208	18,208	18,390	18,574
2.2.6	Mbrojtja sociale	0	0	0	0	0	0	0
2.2.7	Administrimi i pyjeve	8,068	8,278	8,950	8,950	8,950	9,039	9,130
2.2.8	Rrugët	19,824	20,378	22,704	22,704	22,704	22,932	23,161
2.2.9	Ujitja dhe Kullimi	12,563	12,828	13,233	13,233	13,233	13,365	13,499
2.2.10	Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti"	0	0	0	0	0	0	0
2.2.11	Menaxhimi i mbetjeve urbane	0	0	6,938	6,938	6,938	7,007	7,078
2.2.12	Rritja e nivelit të pagave	0	0	15,342	15,342	27,618	27,618	27,618
2.2.13	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
2.3	**TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA**	0	0	0	0	0	0	0
2.3.1	Për funksione të deleguara	0	0	0	0	0	0	0
2.3.2	Për projekte të veçanta	0	0	0	0	0	0	0
2.4	**TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA**	17,841	21,187	20,200	20,200	23,700	23,800	24,820
2.4.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	8,894	10,492	10,000	10,000	11,300	11,500	12,200
2.4.2	Renta minerare	173	57	180	180	1,000	800	800
2.4.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	7,426	9,498	8,500	8,500	9,500	9,700	9,800
2.4.4	Të tjera	1,348	1,140	1,520	1,520	1,900	1,800	2,020
2.5	**TRANSFERTË SPECIFIKE**	0	0	0	0	0	0	0
2.5.1	Transfertë specifike	0	0	0	0	0	0	0
3	**GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA**	1,678	6,286	0	0	0	0	0
3.1	**TRANSFERTA NGA I NJËJTI NIVEL QEVERISJE**	0	6,000	0	0	0	0	0
3.1.1	Transferta nga i njëjti nivel qeverisje	0	6,000	0	0	0	0	0
3.2	**GRANTE TË TJERA TË BRENDSHME**	0	0	0	0	0	0	0
3.2.1	Grante të Tjera të Brendshme	0	0	0	0	0	0	0
3.3	**GRANTE TË HUAJA**	1,678	286	0	0	0	0	0
3.3.1	Grante të huaja	1,678	286	0	0	0	0	0
4	**HUAMARRJA**	0	0	0	0	0	0	0
4.1	Huamarrja afatshkurtër	0	0	0	0	0	0	0
4.2	Huamarrja afatgjatë	0	0	0	0	0	0	0
5	**TRASHËGIMI NGA VITI I KALUAR**	115,905	117,894	153,708	153,708	0	0	0
5.1	Trashëgimi pa destinacion	0	0	0	0	0	0	0
5.2	Trashëgimi me destinacion	115,905	117,894	153,708	153,708	0	0	0
TOTALI I TË ARDHURAVE TË NJVQV		500,009	534,667	666,948	666,948	545,367	569,451	588,264

4.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë PRRENJAS

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

A. Taksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Taksës së pasurisë së paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizik ose juridik,vendas ose të huaj , pronar apo përdorues së pasurisë së paluajtshme , në territorin e RSH, pavarsisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin mbi taksën e pasurisë së paluajtshme e ka, sipas rastit, pronar ose bashkëpronarë, sipas pjesës që zotëron, apo përdorues i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisur me dokumente pronësie .

<u>Në taksën e pasurisë së paluajtshme përfshihen :</u>

- **a- Taksa mbi Ndërtesën**
- **b- Taksa mbi Tokën Bujqësore**
- **c- Taksa mbi Truallin**

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit nëse pasuria e paluajtshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë.
Në rast të mungesë së dokumentit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë ka të drejtë të bëjë vetëdeklarim të sipërfaqes pranë Bashkisë Prrenjas, e cila ka të drejtë që të ngrejë një komision /grup pune, nga stafi i Drejtorisë së të Ardhurave, i cili bën matjet faktike në terren të sipërfaqes përkatëse dhe më pas ky akt-konstatim i kalon për vlerësim kësaj drejtorie konform ligjit "Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore", i ndryshuar.
Taksës së ndërtesës i nënshtrohen individë, persona fizikë ose juridikë vendas ose të huaj, personat që kanë aplikuar për legalizim, personat që janë në proces ndërtimi sipas lejes së ndërtimit, por të pa mbyllur në kohë.

Drejtoria e të Ardhurave, Taksave dhe Tarifave Vendore është përgjegjëse për administrimin e taksës së ndërtesës, mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve, përditëson të dhënat në regjistrin qëndror të bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme (kadastra fiskale).

- Nisur nga ndryshimi i taksës së ndertesës, ku për familjaret ka një rritje në 3-4 fishe dhe për veprimtaritë ekonomike shkon me ulje , bazuar në pikën 3 të VKM nr. 132 dt 07.03.2018 me + - 30 kemi vendosur :

    a. Zbritje të taksës së ndërtesës në masën **- 30 %** për njësitë administrative Qukës, Rrajcë, Stravaj .
    b. Rritje të taksës së ndërtesës në **+ 30 %** për ish-bashkinë Prrenjas.

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në dynym, në pronësi të taksapaguesit, kush paguan deri më dt 31 dhjetor 2024 kjo taksë do të ketë një zbritje deri në 30% vetëm detyrimit për vitin 2024, jo detyrimeve të prapambetura, për të stimuluar pagesat që të kryhen për gjatë gjithë vitit.

Taksa mbi truallin është sipërfaqja e truallit në m^2, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit, është detyrim vjetor dhe paguhet gjatë vitit fiskal ku vlera e taksës së truallit për qëllim biznesi do të jetë 18 lekë/m^2/vit.

- Përjashtohen nga taksa e ndërtesës Pronësitë bazuar në ligjin 106/2017 neni 22 pika 6.

Taksa e ndikimit ne infrastrukturë,

1. **Baza e taksës** është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investimi ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.
2. Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1-3 për qind e vlerës së investimit, në bashkinë Prrenjas do të aplikohet niveli si më poshtë:
    - Për ndërtimet familjare **1 %**
    - Ndërtimet për efekt biznesi **2 %**
    - Magazinë bujqësore dhe Agroturizëm **1 %**.

Taksa e fjetjes në hotel

- **Përkufizimi**: Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë:

a) "Bujtinë";
b) "Fjetinë" (Hostel); c) "Kamping"; ç) "Hotel"; d) "Motel"; dh) "Resort"; e) "Qendër kurative"; ë) "Fjetje dhe mëngjes" (B&B).

- **Baza e taksës** së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel, për person.
- **Niveli i taksës** paraqitet si më poshtë:

Kategoritë minimale të taksës së fjetjes në hotel	Bashkia Prrenjas
Hotelet 4-5yje	105 lekë/ për natë fjetje
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetëra komoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin.	35 lekë/ për natë fjetje

Taksa e tabelës

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.
Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike, juridike, private e shtetërore, vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Prrenjas.

- **Taksë e përkohshme arsimi**

Për vitin 2024 kemi planifikuar taksën e Arsimit e cila do të aplikohet vetëm tek bizneset, ku sipas ligjit kjo taksë mund të aplikohet nga 0- 35 % mbi vlerën e taksës së ndërtesës, kemi menduar që të aplikojmë vetëm 25 % mbi vlerën e taksës së ndërtesës. Për bizneset të cilat nuk kanë ndërtesë (B. Vogël) do të jetë një vlerë prej 2,000 lekësh në vit dhe për biznesin e madh 10,000 lekë/vit.

Arsyet e rritjes së të ardhurave në vite janë:

1. -Rritje e ndërgjegjësimit dhe forcimit të kontrollit periodik nga strukturat përkatëse të bashkisë.
2. -Zgjerimi i bazës se taksueshme dhe sidomos në atë pjesë të të ardhurave nga taksapaguesit familjare, monitorimi në vijimësi i treguesve, planifikimi dhe cilësia e hartimit te tij, lufta e pa kompromis kundër evazionit janë argumente dhe indikatore ndikues.
3. -Përmirësimi në vijimësi i procedurave në marrëdhënie me subjektet taksapagues duke shmangur burokracitë e tepërta dhe të panevojshme, një tjetër indikator që ka ndikimin e vet.
4. -Monitorimi i realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse e tarife sipas faktorëve ndikues, muaj për muaj dhe periodike tremujore.
5. Ndërtimi i marrëdhënieve edhe me bashkëpunuese me agjentët tatimorë; ndërtimi i akteve të rakordimit në mënyrë periodike mes palëve është një tjetër tregues me ndikim.

A.2 Tarifat Vendore

Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:
a) tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave; b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve; c) tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet; ç) tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit; d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve; dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara në ligj; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore; ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.
Referuar ligjit 139/2015 ”Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë,

me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Gjithashtu bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.
Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.
Për vitet 2025-2027 të ardhurat e parashikuara për bashkinë Prrenjas nga tarifat përbëjnë rreth 35% të të ardhurave të veta.
Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifat vendore e zënë të ardhurat nga tarifat për ofrimin e shërbimeve publike të pastrimit e largimit të mbeturinave me 50% të totalit të tarifave, duke qenë edhe një nga aktivitetet kryesore në funksionin e shërbimeve publike, të gjelbrimit me 4%, të ndriçimit publik me 6%, të shërbimit administrativ të bashkisë me 39%, ku bëjnë pjesë tarifa për pyje e kullota, tarifa për licensimin e karburanteve, tarifa të institucioneve etj.

Të ardhura nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit.

Parashikimi i të ardhurave nga tarifat për pastrimin, ndriçimin dhe gjelbërimin, bazohet tek kapaciteti aktual dhe në rritjen e njësive taksapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit te shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Kontribuesit e taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative.Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat e rregjistrave për taksapaguesit, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak.
Në total kapaciteti i taksapaguesve është parashikuar rreth 6,139 (familje, biznese dhe institucione). Peshën numerike më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë familjet, rreth 91.8%. Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe njësive administrative.

Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupimeve

Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupimeve

KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE (Numri)

Nr	Bashkia Prrenjas	Familje	Biznese
I	Njësia Administrative Prrenjas	889	282
II	Njësi Administrative të tjera	4750	218
	TOTALI		

Taksapaguesit familjarë


Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke iu referuar kapaciteteve reale të familjeve rezidente sipas Censusit, si dhe lehtësive fiskale të miratuara.


Në total numri i familjeve që përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Prrenjas është 5639. Në paketën fiskale të Bashkisë Prrenjas janë parashikuar lehtësi fiskale dhe numri i këtyre familjeve arrin në 2029 familje si pensionistë, invalid, familje me ndihmë ekonomike, familje njëprindërore, familje me probleme sociale etj. Ato zënë 26 % të numrit të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Prrenjas.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për familjet sipas kategorive/lehtësive fiskale dhe sipas Njësive Administrative:

Kapaciteti i familjeve taksapaguese sipas grupimeve

Nr	Bashkia Prrenjas	Totali i familjeve	Familje me taksa/tarifa të plota	Familje me lehtësi fiskale	Me lehtësi fiskale: Pensionistë, invalidë etj.	Me lehtësi fiskale: nd.ekonomike.
I	NjA Qendër	2156	889			
II	NjA të tjera	5512	4750			
	TOTALI	7668	5639		780	1249





Shperndarja e popullsise ne Bashkine Prrenjas

Kapacitetet fiskale per taksapaguesit familja

Taksapaguesit biznese dhe institucione


Bazuar në rregjistrat aktual, në total, numri i bizneseve dhe institucioneve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale te bashkisë Prrenjas është 500. Biznesi i vogël zë rreth 82% të numrit total të bizneseve.
Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për bizneset dhe institucionet, sipas Njësive Administrative:

KAPACITETI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE TAKSAPAGUESE

Nr	Bashkia Prrenjas	Totali	Biznes i vogel	Biznes i madh	Institucione

I	**NjA Qendër**	**282**	**224**	**55**	**3**
II	**NjA të tjera**	**218**	**186**	**32**	
	TOTALI	**500**	**410**	**87**	**3**

Shpërndarja e biznesit në Bashkinë Prrenjas




Në tabelën e mëposhtme, për bizneset e vogla vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregti dhe shërbime me 88% ndaj totalit të bizneseve të vegjël.

KAPACITETI I BIZNESEVE TE VOGLA SIPAS NATYRES SE TYRE

Nr	Bashkia Prrenjas	Biznesi i vogël	Nga kjo:			
			Njësi tregtare dhe shërbimi	Njësi prodhimi	Profesione te lira	Ambulantë
I	NjA Prrenjas	**410**	**384**	**5**	**4**	**17**
	TOTALI					

Kapacitetet e biznesit të vogël



Kapacitetet e biznesit të vogël


Në tabelën e mëposhtme, për bizneset e mëdha, vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregti dhe shërbime me 67.7 % ndaj totalit të bizneseve të mëdhenj.

Kapaciteti i bizneseve te medha sipas natyres se tyre

KAPACITETI I BIZNESEVE TE MEDHA SIPAS NATYRES SE TYRE

	Bashkia Prrenjas	Biznesi i madh	Nga kjo:					
			Njësi tregëtare dhe shërbimi	Njësi tregtare për tregëtim karburanti	Njësi prodhimi	Subjekte ndërtimi	Ente shtetërore, OJF, etj.	Institucione
I	Prrenjas	90	65	6	14	2		3
	TOTALI							

